

TERMA E KONCEPTE GJENERATIVE NË SINTAKSËN E GJUHËS SHQIPE GJENERATIVE CONCEPTS IN TERMS OF THE ALBANIAN LANGUAGE SYNTAX

ORJETA DUSHI

Universiteti "Luigj Gurakuqi", Fakulteti i Shkencave Shoqërore, Departamenti i Gjuhësisë, Shkodër,
ALBANIA

Email: orjeta.dushi@live.com

AKTET VI, 4: 456-460, 2013

PERMBLEDHJE

Qëllimi i kërkimit është pasqyrimi i vlerave kuptimore të termave e të koncepteve gjenerative në sintaksën e gjuhës shqipe dhe risitë e përdorimit të tyre në terminologjinë gjuhësore të sintaksës gjenerative të shqipes. Me futjen në përdorim të metodave përshkruese, krahasuese e shpjeguese do të përpiqemi t'i arrijmë rezultatet e mëposhtme.

1. Terminologjia e sintaksës së shqipes është zgjeruar në drejtim të pastrimit nga terminologjia e huaj dhe në drejtim të pasurimit të terminologjisë shqiptare

2. Gjymtyrët e dyta funksionale në trajtimin gjenerativist kanë ndryshuar jo vetëm terminologjinë, por edhe fushën e përdorimit të tyre në raport me pozicionin ku ndodhen. Konkretisht: përcaktorët (specifikues, cilësor e plotësor), kundrinorët (argument, plotësor), rrethanorët (cirkostantë), determinantët, modifikuesit.

3. Risi është këndvështrimi i emërimit të gjymtyrëve të dyta në bazë të pozicionit në strukturën e sintagmës X. Përkufizimet për fjalinë e thjeshtë. Projektioni maksimal i PRSH. Rregullat e strukturës së frazës të sintagmave foljore në trajtimin gjenerativ.

Hyrja e termave gjenerativë në sintaksën e shqipes shpjegon mundësinë e studimit të saj përkrah gjuhëve të tjera, në gjetjen e universalieve gramatikore absolute e relative dhe dëshiroj që kjo terminologji të zërë vend në diskutimet shkencore rreth gjuhësisë shqiptare.

Fjalë kyçe: koncepte gjenerative, sintaksa e shqipes, struktura e sintagmës X.

SUMMARY

Review of the semantic values of generative terms and concepts in the Albanian language syntax and the innovations in the use of linguistic terminology of the generative Albanian syntax represent the purpose of this study. Through the inclusion of the use of the descriptive, comparative and explanatory methods, we will try to reach the following results.

1. The Albanian syntax terminology is enlarged in terms of clearance of foreign terminology and in the enrichment of Albanian terminology.

2. The second functional parts in terms of generativist treatment have not only changed the terminology, but even the field being used in relation to their position. Concretely: de-te-r-minants (specifiers, qualifiers and additives), objects (argument, additives), complements, determinants, modifiers.

3. Innovation is the view of naming of the second parts based on the syntagma structure X. Definitions for the simple sentence. The maximum projection of PRSH. Phrase structure rules of verbal phrases in the generative treatment. Introduction of the generative terms in the Albanian syntax explains its opportunity to study alongside other languages, finding the absolute and relative grammatical universals. I wish that this terminology take place in scientific discussions about Albanian linguistics.

Key words: Gjenerative concepts, Albanian syntax, syntagma X.

Hyrja

Njëri prej synimeve të mija ka qenë të nxjerrë në pah vlerat kuptimore të termave dhe risitë e përdorimit të tyre në terminologjinë gjuhësore të sintaksës gjenerative në gjuhën shqipe.

Kjo bëhet për të ndihmuar studiuesit në përdorimin sa më drejtë të termave e koncepteve të reja, për arsye se kuptimi i një pjese të madhe të fjalëtermave nuk njihet ose është i paqartë, kështu që nuk është e lehtë të zbulosh kuptimin e tyre nga konteksti.

Ky studim do të paraqesë *mundësinë e gjuhës shqipes për t'u studiuar si një gjuhë në raport me gjuhët e tjera*, në gjetjen e universaleve absolute e relative dhe *ndihmesën e gjuhëtarëve për të pastruar dhe pasuruar terminologjinë shqiptare nga terminologjia e huaj*.

Në këtë punim do t'u sqaroj për *gjymtyrët e dyta funksionale*, të cilat sipas trajtimit gjenerativist kanë ndryshuar fushën e përdorimit të tyre në raport me pozicionin ku ndodhen sipas strukturës së sintagmës X, për *përkufizimet e gjuhëtarëve shqiptarë për fjalinë e thjeshtë* sipas këndvështrimit gjenerativ, për *projeksioni maksimal i PRSH dhe për rregullat e strukturës së frazës të sintagmave foljore në trajtimin gjenerativ*.

Të gjitha këto risi në terminologjinë tradicionale shqiptare, kryesisht në gramatikë e sintaksë, nëpërmjet këtij punimi do paraqesin çështje pas çështjeje një fytyrë të re të gjuhësisë sonë, atë të gramatikës gjenerative bashkëkohore shqiptare.

1. Shqipërimi i termave

Në fjalorët terminologjikë, njësitë e përbëra terminologjike ose kombinimet terminologjike si terma-togfjalësh në gjuhësinë gjenerative janë mënyrat më të përdorura në ndërtimin e termave shkencorë nga gjuhëtarët.

Përsa i takon **terminologjisë** ndeshemi me dukurinë e futjes së terminologjisë së huaj në gjuhësinë shqiptare, si: p. sh. actant, adjectiv, adjuksionet, cirkostantë, konstituente-bërthamë, konstituente-jobërthamë.

Ndihmesën më të madhe në drejtim të *pastrimit e pasurimit të terminologjisë shqiptare* në këtë

fushë e kanë dhënë përkthyesit e veprave të themeluesve të këtij drejtimi gjuhësor dhe gjuhëtarët shqiptarë Rahmi Memushaj e Josif Mita me veprat e tyre, duke përdorur terma të shqipëruar, si p.sh. **në drejtim të pastrimit**: drejtim nga koka (angl. Head government); elemente ndihmëse (angl. Auxiliary); eptimi (angl. Flexion); kallëzuesia (angl. Predicate); lëvizje të fshehura (angl. Couvert); **në drejtim të pasurimit**: përngjitje (angl. Agglutination); përemra shënues (angl. Espletivet); periudha (angl. Complex sentence); pranueshmëria (angl. Acceptability); rimarrja (angl. Anaphora).

Termi i shqipëruar ndihmon lexuesin për të kuptuar përmbajtjen e termit duke e mbajtur mend më lehtë për të diskutuar rreth teorive të reja të drejtimit gjenerativ, që po futen me ritme të shpejta në gjuhësinë shqiptare. Konkretisht: roli tematik i jashtëm; rregullat e strukturës së frazës; struktura e kllapave të etiketuara; struktura e sintagmës emërore; rrangu kryesor i pjesëve të ligjëratës. Megjithatë njësitë e zgjeruara gjuhësore me kalimin e kohës mund të shkurtohen në shprehjen e koncepteve deri në togfjalësha të thjeshtë (p.sh. rregullat e nominalizmit / emërzimi), ose deri në fjalë të përbëra (p. sh. Adjectiv: adverb (ndajfolje) + adjective (mbiemër).

2. Funkioni i gjymtyrëve të dyta

Gjymtyrët e dyta funksionale në trajtimin gjenerativist kanë ndryshuar jo vetëm terminologjinë, por edhe fushën e përdorimit të tyre në raport me pozicionin ku ndodhen.

Kështu për një term ekzistues mund të kemi shumë kuptime në lidhje me pozicionin e tij në sintagmë ose fjali. Tashmë termi ekzistues fiton një emërtim të ri dhe një polisemantikë. Më konkretisht: - *përcaktorët* në gjuhësinë gjenerative kanë vlerën e specifikuesit, cilësorit e të plotësorit. Në gramatikën gjenerative *specifikues* quhen një numër fjalësh shërbyese, që qëndrojnë para kokës së sintagmës. Për shembull përemrat dëftorë, të pacaktuar, fjalët e shkallës së mbiemrave, nyjet joshqese.

Elementet që shoqërohen me sintagmat (SE, SF, SM, SP) Çomski i quan si specifikues të tyre, sepse

tregojnë veçoritë gramatikore të kokës së sintagmës. Konkretisht në sintagmat emërore specifikuesi është përcaktor, në sintagmat mbiemërore është një fjalë shkalle, në sintagmat foljore është një element ndihmës ose modal.

- Përcaktori luan rolin e *cilësorit*, kur bëhet fjalë për sintagmat emërore në rastin e përcaktimit kuptimor të kokës së sintagmës. P. sh. Ata të gjithë janë *burra të qojës e të pushkës*.

- Një SE përveç kokës përbëhet edhe nga *plotësorët*, që mund të jenë një fjalë e vetme, një sintagmë ose një fjali (përcaktore-lidhore dhe lidhëzore). P. sh. Ky autobus, ndeshje e fituar, besimi që i krijuan mjekët. Deri tani termi “plotësorë” është përdorur vetëm në lidhje me shprehjet emërore dhe mbiemërore, të cilat bashkohen me këpujën në fjali si:

a) *Maria është një vajzë e bukur.*

b) *Maria është e bukur.*

- Me *plotësorë kallëzuesor* shënohen të gjitha ato fjalë ose grupe fjalësh (me përjashtim të vetë foljes) që janë konstituente të detyrueshme të kallëzuesit, si p. sh. Kundrinori i një foljeje kalimtare. Plotësori kallëzuesor është sintaksisht i domosdoshëm për plotësimin e strukturës kallëzuese (prandaj quhet “komplement”, përkatësisht “plotës”). Plotësori përdoret veçanarisht për shprehjet ndajfoljore. Dallimi midis një adjuksioni dhe një plotësori kallëzuesor është i qartë: i pari është një konstituente fakultative (jobërthamë) e fjalisë, kurse i dyti është konstituente e detyrueshme (bërthamë).

- *Kundrinorët* në gjuhësinë gjenerative quhen me termin “argument”, i cili përdoret për të emërtuar sintagmat emërore, që lidhen me foljen (kryefjalën dhe kundrinorët), por në vend të tij përdoret edhe emri “plotësor”. Plotësorët (*kundrinorë*) janë *argumente të brendshme* që zgjidhen nga koka e sintagmës. Fjalët, që u përkasin kategorive leksikore (emri, folja, mbiemri), që shërbejnë si kokë e sintagmave mund të marrin plotësorë.

3. Përcaktimi i gjymtyrëve të dyta

Në gjuhësinë gjenerative “argumenti i brendshëm” ose “plotësori” quhen edhe “objekt”. Ata janë disa llojesh në raport me rolet tematike që u

cakton folja. Sipas numrit të argumenteve që merr një folje përcaktohen edhe valencat e saj. Ato grupohen në:

(a) *Folje zerovalente: bubullon, gjëmon;*

(b) *Folje njëvalente: Agroni ecën; Babai u zgjua;*

(c) *Folje dyvalente: Vajza vështron qiellin; Djali nuk u bindet prindërve;*

(d) *Folje trivalente: Janë foljet e tipit them dhe jap: Djali i tha (i dha) diçka vajzës.*

Kjo ndarje nuk përkon me ndarjen tradicionale të foljeve në pavetore, jokalimtare dhe kalimtare.

- *Rrethanorët* në gjuhësinë gjenerative quhen “cirkostantë”. Cirkostantët janë gjymtyrë që varen ose jo nga kallëzuesi dhe që luajnë një rol jo të rëndësishëm në fjali, prandaj janë quajtur *periferikë* (nga Tesnière 1959; dhe Graffi 1994: 53).


Funksionin e rrethanorit e luan edhe plotësi në gjuhësinë gjenerative. Plotësi është përbërës në teorinë X-bar, që mund të zërë pozicione të ndryshme në sintagmë dhe përfshin të gjitha gjymtyrët periferike të fjalisë, pra rrethanorët dhe përcaktorët e veçuar. Konkretisht në plotës kohe, kufizimi, qëllimi, rrethanor sasive, shkaku, vendi. Trajtimi i plotësve përbën një çështje ende të hapur të teorisë X-bar.

- *Komplement* ose “plotësor” quhet elementi, që i përket përbërësit që modifikon kokën e sintagmës në projektionin zero.

- Me *modifikues* duhen kuptuar përbërës të sintagmës, që kanë funksion kufizues ndaj kokës leksikore dhe si të tillë ata lidhen me emrin, i cili ka nevojë për kufizimin e kuptimit (Lieber 1992: 38). Modifikuesit, specifikuesit dhe plotësorët sipas tipit të gjuhëve mund të vendosen para ose pas kokës së frazës. Kjo ka të bëjë me veçantitë e secilës gjuhë dhe me funksionin që ato kryejnë në gramatikën e saj.

- *Determinantët* ose ndryshe “*caktuesorët*” janë pjesë përbërëse e sintagmave emërore (SN). Në paraqitjen grafike ato kanë simbolin Det (shkurtim i “determinant”). Së bashku me emrin ato formojnë në bazë të operacionit Merge sintagmën emërore (SN). P.sh. *quell'uomo*.

Në teorinë X-bar pozicioni i gjymtyrëve të dyta në raport me kokën e sintagmës shpje-go-het me anë të skemës universale.



4. Përcaktimi i fjalisë së thjeshtë

Në historinë e gjuhësisë **fjalia e thjeshtë** njihet me këto terma: Në **latinisht** si: mënyrë të foluri e pa të metë, -phrasi (m), e cila në **greqisht**-Phrasis, deriv. phrâzein ka kuptimin të "thonë"; në **shqip** -Fjali-a,-të; **rus**.-предложение; **fr.** -proposition; **angl.**-clause, sentence; **gjerm.** -Satz; **it** -proposizione. Po kështu dhe për togfjalëshin **-fjali dykryegjymtyrëshe** -në shqip; **rus.**- двусоставное реуение; **fr.** -dirème; **gjerm.** -zweigliedriger. Emërtimet e këtij termi së bashku me llojet ndodhen edhe në "Fjalorin krahasues të termave të gjuhësisë" (në shqip, italisht, frëngjisht, anglisht) të autorëve G. Belluscio e Sh. Rrokaj të vitit 2011.

Simbolikisht **fjalia** në gjuhësinë gjenerative shqiptare shënohet: Fj. Kjo tregon që emërtimet për këtë njësi nuk kanë ndryshuar. Vetëm përkufizimet për të janë të larmishme sipas këndvështrimeve gjuhësore. Sipas studiuesit të gjuhësisë gjenerative shqiptare R. Memushaj "fjalja është njësi gjuhësore themelore, e kuptuar si një gjykim i shprehur me gojë ose me shkrim, që përbëhet nga plani i shprehjes dhe i përmbajtjes, që ka funksion kumtues dhe intonacion predikativ dhe ka kallëzuesinë si tipar të pamungueshëm të saj". Për J. Mitën: "fjalja është projeksioni maksimal i eptimit të foljes, argumenti i eptimit është SF, ndërsa si specifikues i eptimit është subjekti." Fjalja mund të shihet si një lloj sintagme që i përmban të gjitha të tjerat. "Fjalja është projeksioni maksimal i eptimit të foljes." Përgjithësisht pranohet që eptimi i foljes (fleksioni) është koka e fjalive, të cilat ndahen në **koka leksikore** F(olje), E(mër), Mb(iemër), P(ëremër) dhe në **koka funksionale**.

5. Projeksioni maksimal i PRSH tregon lidhjen e përshtatjes së foljes me kryefjalën: PRSH-krf, jo

vetëm realizon përshtatjen e foljes së shtjelluar me kryefjalën, por ka edhe funksionin për t'i caktuar Rasën emërore vetë kryefjalës; PRSH-knd, nga ana e vet, ka funksionin t'i caktojë rasë kallëzore kundrinorit të drejtë të F. Koncepti i kryefjalës në këndvështrimin gjenerativist quhet subjekt. **Subjekti** është ai element që zë pozicionin e specifikuesit të SEPT ose të SE. **Folja** është bërthamë në një fjali dhe krijon raporte varësie me argumentet e saj duke përfshirë këtu edhe kryefjalën. Ajo mban të njëjtën peshe organizative në fjali si në gjuhësinë tradicionale, ashtu edhe në atë gjenerative.

Në trajtimin gjenerativ rregullat e strukturës së frazës të sintagmave foljore janë:

- 1) SF → Spec, F'
- 2) F' → F, Argument.

Përfundim

Si rezultat i përdorimit të metodave përkrahuese, krahasuese dhe shpjeguese gjatë këtij studimi arrita në këto konkluzione.

1. Hyrja e termave të gjuhësisë gjenerative në sintaksën e shqipes, shpjegon mundësinë e madhe të shqipes për tu studiuar si një gjuhë në raport me gjuhët e tjera, në gjetjen e universaleve absolute e relative.

2. Ndryshimet në leksikologji i përkasin terminologjisë së sintaksës së shqipes, e cila është zgjeruar në drejtim të pastrimit nga terminologjia e huaj dhe në drejtim të pasurimit të terminologjisë shqiptare.

3. Në gramatikë ndryshimet kanë një ritëm më të ngadaltë, sepse gjymtyrët e dyta funksionale në trajtimin gjenerativist kanë ndryshuar fushën e përdorimit të tyre në raport me pozicionin ku ndodhen. Konkretisht: përcaktorët (specifikues, cilësor e plotësor), kundrinorët (argument, plotësor), rrethorët (cirkostantë), determinantët, modifikuesit.

4. Risi është këndvështrimi i emërtimit të gjymtyrëve të dyta në bazë të pozicionit në strukturën e sintagmës X. Pranimi i termave gjenerativë në gjuhësinë shqiptare u jep mundësinë gjuhëtarëve shqiptarë dhe të huaj për studime krahasuese për terma e koncepte të nënsistemeve të gjuhës shqipe.

5. *Përkufizimet e reja* të gjuhëtarëve shqiptarë për *fjalinë e thjeshtë* sipas këndvështrimit gjenerativ, për *projeksionin maksimal të PRSH* dhe funksionin e tij dhe paraqitjen e rregullave të strukturës së frazës të sintagmave foljore në trajtimin gjenerativ.

6. Risetë, që termat gjenerativë sjellin në gramatikën tradicionale shqiptare, krijojnë një fytyrë të re të gjuhësisë sonë, të gramatikës gjenerative bashkëkohore shqiptare. Dëshiroj që këto rezultate dhe risi të zënë vend në komunikimin akademik të studiuesve e gjuhëtarëve shqiptarë dhe të huaj.

Bibliografia

AKADEMIA e Shkencave e RPSH (1975), *Fjalori i Termave të Gjuhësisë*.

GARZANTI (), *Dizionario Interattivo*

MITA, Josif (2005), *Hyrje në sintaksën gjenerative*, Shpresa, Prishtinë.

LYONS, J. (2001), *Hyrje në gjuhësinë teorike* (1968), përkth. E. Likaj, Dituria, Tiranë.

DOMI, Mahir (1984), *Dukuri të zhvillimit të strukturës sintaksore të gjuhës së sotme letrare shqipe: Studime filologjike*, Tiranë, nr. 4.

MEMUSHAJ, Rahmi (2003), *Gjuhësia gjenerative*, Tiranë.

MEMUSHAJ, Rahmi (2006), *Hyrje në gjuhësi*, Toena, Tiranë. .